

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-30/019	Data: Datum: 05.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe nenin 10, paragrafi 5 i Rregullores Komunale për punën e Kuvendit të Komunës së Istogut Nr. 2/2013, kërkesën 05 Nr. 37/19, të datës 01.02.2019 të Drejtorisë për Arsim si dhe duke pasur parasysh nevojën për Plotësim-ndryshimin të Rregullores Komunale Nr. 02/2017 për Ndarjen Bursave për student nxjerr:


V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Plotësim-ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 02/2017 për Ndarjen Bursave për student dhe në të caktohen:
 - 1) Hajrush Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kryesues Komisioni;
 - 2) Sami Ferati, Udhëheqës i Arsimit, anëtar;
 - 3) Sami Metaj, Zyrtar i Lartë Ligjor, anëtar;
 - 4) Faton Bujupi, Zyrtar Ligjor;
 - 5) Fazli Stollaj, Zyrtar për IT dhe
 - 6) Arlinda Kurtaj, Udhëheqëse e Sektorit për punë administrative të KK-së, punë të përbashkëta dhe çështje teknike.
2. Komisioni do të bëjë Plotësim-ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 02/2017 për Ndarjen Bursave për student; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin e Plotësim-ndryshimit të cekur me lartë dhe pas përfundimit kopjen e Plotësim-ndryshimit do t'ia dorëzojë Kryetarit; do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit që janë në natyrën e këtij komisioni.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e komisionit.
4. Komisioni të fillojë me punë menjëherë, të gjitha punët juridike-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra Ligjore.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-31/019	Data: Datum: 05.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar sipas konkursit 02 Nr. 13/19 të datës 25.01.2019 nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 02 Nr. 13/19 të datës 25.01.2019, për pozitën, **Inspektor i Komunikacionit**(marrëveshje për shërbime të veçanta – kohëzgjatja 6 muaj) në kuadër të Drejtorisë për Inspektion dhe në të caktohen:
 1. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, kryesues;
 2. **Naser Gjocaj**, Zyrtar për hapësira publike dhe efikasitet të energjisë, anëtar;
 3. **Dukagjin Hoxhaj**, Zyrtar për Regjistrimin e adresave, anëtar;
 4. **Abedin Neziraj**, Zyrtar për kthim të qëndrueshëm, anëtar dhe
 5. **Elfete Blakaj**, Udhëheqëse e Sektorit për mbrojtje të Mjedisit, anëtar.
 2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën, Inspektor i Komunikacionit (marrëveshje për shërbime të veçanta – kohëzgjatja 6 muaj) në kuadër të Drejtorisë për Inspektion në pajtim me procedurat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftojnë udhëheqësin e personelit për procedim të mëtejshëm.
 3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevojat e komisionit do t'i kryejë, zyra e personelit.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen anëtarët e komisionit.
- Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit, menaxheri i personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-32/019	Data: Datum: 05.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe nenin 10, paragrafi 5 i Rregullores Komunale për punën e Kuvendit të Komunës së Istogut Nr.2/2013, duke pasur parasysh nevojën për hartimin e Projekt-Rregullores për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për hartimin e Projekt-Rregullores për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve dhe në të caktohen:
 1. **Sanije Mavraj**, Koordinatore për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kryesuese;
 2. **Sami Metaj**, Zyrtar i Lartë Ligjor, anëtar;
 3. **Fahrije Gashi**, mjeke në QKMF në Istog, anëtare;
 4. **Naim Sylaj**, Zyrtar për Shërbime Sociale 2, anëtar;
 5. **Muhamet Gusturanaj**, Zyrtar për Integritet Evropian, anëtar;
 6. **Abedin Neziraj**, Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm dhe
 7. **Arlinda Kurtaj**, Udhëheqëse e Sektorit për punë administrative të Kuvendit Komunal, punë të përbashkëta dhe çështje teknike.
2. Komisioni do të bëjë hartimin e Projekt-Rregullores për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin Projekt-Rregullores së cekur më lartë dhe pas përfundimit kopjen e Projekt-Rregullores do t'ia dorëzojë Kryetarit; do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit që janë në natyrën e këtij komisioni.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e komisionit.
4. Komisioni do të fillojë me punë menjëherë, të gjitha punët juridike-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra Ligjore.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtarët e komisionit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-33/019	Data: Datum: 05.02.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), më qëllim të formimit të Grupit Punues për plotësimin e pyetësorit të Vetëvlerësimit të Kompetentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2018, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për plotësimin e Pyetësorit të Vetëvlerësimit të Kompetentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2018 dhe në grupin punues caktohen:

Osman Sadikaj, ZKF, Koordinator i Grupit Punues dhe përgjegjës për plotësimin online të pyetësorit;

- 1) Hysni Maxharraj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet e Financa, anëtar;
- 2) Jashar Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar;
- 3) Hajrush Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
- 4) Mujë Osmanaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar;
- 5) Besart Dreshaj, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar;
- 6) Demë Çeta, Drejtor i Drejtorisë për Inspektion, anëtar;
- 7) Enver Rugova, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar;
- 8) Lulzim Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, anëtar;
- 9) Edona Bujupi-Loxha, Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratës Komunale, anëtare;
- 10) Hazbi Bajra, Shef i Kabinetit të Kryetarit, anëtar;
- 11) Fatmir Bytyqi, Udhëheqës i Personelit, anëtar;
- 12) Rasim Mahmutovic, Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
- 13) Riza Alihajdaraj, Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, anëtar;
- 14) Zize Bujupi, Menaxhere e Prokurimit, anëtare;
- 15) Zekije Sutaj, Udhëheqëse e Zyrës Ligjore, anëtare;
- 16) Sanije Mavraj, Koordinaore e Zyrës Komunale për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore, mundësi të barabarta dhe persona me aftësi të kufizuara, anëtare;
- 17) Brahim Hetemaj, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi dhe Buxhet, anëtar;
- 18) Hatixhe Arifaj, Menaxhere e Tatimit në Pronë, anëtare;
- 19) Elfete Blakaj, Përgjegjëse për Mjedis, anëtare;
- 20) Muhamet Gusturanaj, Udhëheqës i Sektorit për Integritet Evropiane, anëtar;
- 21) Selman Blakaj, Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile, anëtar;
- 22) Fazli Stollaj, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, anëtar dhe
- 23) Genc Ademaj, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për partneritet publiko-privat, anëtar;
- 24) Fjollë Berisha, Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave, anëtare.

2. Grupi punues i lartcekur ka për obligim që të kontribuoj në plotësimin e Pyetësorit për Vetëvlerësim të Kompetentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2018, të vlerësojnë me nota, komente dhe sugjerime.

3. Grupi punues i lartcekur, ka për obligim që Pyetësin e Vetëvlerësimit të Kompetentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2018, të plotësojë me të dhënat e nevojshme deri me 28.02.2018 si dhe për punën e grupit të njoftojnë Kryetarin.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Koordinatorin e grupit punues, Përgjegjësin për plotësimin online të pyetësit dhe anëtarët e komisionit.

5. Me kopje të këtij vendimi njoftohen: Koordinatorin e grupit punues, Përgjegjësin për plotësimin online të pyetësit, anëtarët e grupit punues dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA**



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-34/019	Data: Datum: 05.02.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), me kërkesë të Udhëheqëses së Sektorit të Prokurimit për formim të komisionit për rivlerësimin e ofertave në projektin "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve e rrugëve lokale të asfaltuara" me numër të prokurimit 633/018/040/521 dhe numër të brendshëm 633/018/744/521, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për rivlerësimin e ofertave në projektin "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale të asfaltuara" me numër të prokurimit 633/018/040/521 dhe numër të brendshëm 633/018/744/521 dhe në të caktohen:

1. **Rasim Mahmutović**, Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, kryesues;
2. **Naser Gjocaj**, Zyrtar për Hapësira Publike dhe Eficiencë të Energjisë, anëtar dhe
3. **Gëzim Ademaj**, Zyrtari i Lartë i Prokurimit, anëtar

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë rivlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve e rrugëve lokale të asfaltuara" si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e Komisionit dhe Sektori i Prokurimit.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Sektori i Prokurimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-35/019	Data: Datum: 14.02.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) të datës 04.06.2008, nenin 69, paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr. 62/2010, të datës 30.11.2010, lidhur me zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.816/2018 të datës 21.01.2019 nxjerr:

V E N D I M

I. Anullohet konkursi për pozitën, **Zyrtar i Gjendjes Civile 1**, me numër të referencës RN00003580 dhe me numër të protokollit 02 Nr.142/18 të datës 10.08.2018, në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale, në përputhje me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.816/2018 të datës 21.01.2019 për shkaqe e theksuara në vendimin përkatës.


II. Të gjitha punët tekniko-administrative për anulim do t'i kryejë, zyra e personelit.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Menaxheri i Personelit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohet: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Udhëheqësi i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



**Kryetari i Komunës,
Haki RUGOVA**

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-37/019	Data: Datum: 14.02.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 8 të Rregullores MF-Nr.4/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe me kërkesë të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për formimin e Komisionit lidhur me vlerësimin e ofertave në projektin "Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive me rastin e shënimit të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë " nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni lidhur me vlerësimin e ofertave në projektin "Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive me rastin e shënimit të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë " dhe në të caktohen:

1. **Bedri Hajzeraj**, Udhëheqës për Kulturë, Rini dhe Sport, kryesues;
2. **Agim Ahmetaj**, Zyrtar për Emergjencë, anëtar;
3. **Qefser Ibrahimaj**, Udhëheqës për Kulturë, anëtare;
4. **Sami Ferati**, Udhëheqës i Sektorit të Arsimit, anëtar dhe
5. **Besnik Metaj**, përfaqësues i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, anëtar.

2.Komisioni i cekur me lartë ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha projekteve konkurruese në bazë të thirrjes publike për mbështetje financiare të OJQ-ve të datës 29.01.2019, të përpilojë listën e OJQ-ve dhe t'i rendit ato sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit të projekteve, me listën e përpiluar të njoftojë Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni për vlerësimin e projekteve me thirrje publike dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni për vlerësimin e projekteve me thirrje publike, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-39/019	Data: Datum: 15.02.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për caktim të mbikëqyrësit për realizimin e projektit: "Ndërtimi i depos së shtëpisë së komunitetit në Gurakoc, me numer të brendëshem prokurimi 633/018/079/521, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** mbikëqyrës **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për realizimin e projektit: "Ndërtimi i depos së shtëpisë së komunitetit në Gurakoc, me numer të brendëshem prokurimi 633/018/079/521.
2. I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projektit detal ekzekutive; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Mbikëqyrësi i projektit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Naser Gjocaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-40/019	Data: Datum: 19.02.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58, pika m, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) të datës 04.06.2008, nenin 69, paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr. 62/2010, të datës 30.11.2010, shqyrtoi kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim, Hajrush Shoshi, 05 Nr. 49/19 të parashtruar me 19.02.2019, për caktimin e Komisionit “ ad hoc” për shqyrtimin e ankesave në Drejtorinë e Arsimit, lidhur me konkursin 05 Nr. 14/19, të datës 14.01.2019, për pozitat “Një mësimdhënës/e për Edukatë Fizike (zëvendësim)”, në Gjimnazin “ Haxhi Zeka” në Istog dhe “Një mësimdhënës/e për Edukatë Fizike (zëvendësim)”, në SHFMU “ Trepça” në Banjë dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni “ ad hoc” për shqyrtimin e ankesave në Drejtorinë e Arsimit, lidhur me konkursin 05 Nr. 14/19, të datës 14.01.2019, për pozitat “Një mësimdhënës/e për Edukatë Fizike (zëvendësim)”, në Gjimnazin “ Haxhi Zeka” në Istog dhe “Një mësimdhënës/e për Edukatë Fizike (zëvendësim)”, në SHFMU “ Trepça” në Banjë, me këtë përbërje:
 1. **Faton Bujupi**, Zyrtar Ligjor 2, kryesues i komisionit;
 2. **Sami Metaj**, Zyrtar i Lartë Ligjor, anëtar dhe
 3. **Qefser Ibrahimaj**, Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit, anëtare.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Hajrush Shoshi.
3. Vendimi është përfundimtar dhe vlen vetëm për këtë rast.

Me kopje të këtij vendimi të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA**



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-41/019	Data: Datum: 19.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), në kuadër të aktivitetit të prokurimit me qëllim të caktimit të Menaxherit për zbatimin e kontratës “Pastrimi i qytetit” me numër të prokurimit **633-17-515-2-2-1 FA/022** dhe numër të brendshëm **633/018/003/221**, nxjerr:

V E N D I M

1. Caktohet Menaxher i projektit, **Agim Ahmetaj**, Zyrtar për Emergjencë në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për zbatimin e kontratës “Pastrimi i qytetit” me numër të prokurimit **633-17-515-2-2-1 FA/022** dhe numër të brendshëm **633/018/003/221**;
2. I lartpërmenduri do të jetë menaxher për zbatimin e kontratës të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftojë Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit (kontratës) së të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij kujdeset: **Agim Ahmetaj**, Zyrtar për Emergjencë në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Agim Ahmetaj**, Zyrtar për Emergjencë dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-42/019	Data: Datum: 19.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-6666, të datës 15.02.2019 të parashtruar nga Adelina Meshi, nga Istogu, për përkrahje furnizim me karburant dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MITATOHET: kërkesa Nr.06-553-6666 të datës 15.02.2019 e parashtruar nga Adelina Meshi, për përkrahje me karburant për realizimin e vizitave mjekësore dhe i lejohet furnizimi i automjetit me 200 litra karburant për dy muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurën me Vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Adelina Meshi, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-6666, me 15.02.2019, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj për realizimin e vizitave mjekësore për shkak të sëmundjes nga e cila vuan.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Adelina është e sëmurë, vuan nga sëmundja e kancerit dhe ka nevojë që të dërgohet për vizita mjekësore.

E lartpërmendura është e sëmurë rënd dhe nuk ka mjete financiare të mjaftueshme që të sigurojë transportin e saj. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale, nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që t'i ndihmohet përmes furnizimit me karburant.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më Vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.


Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Adelina Meshi, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-44/019	Data: Datum: 21.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-7446, të datës 21.02.2019 e parashtruar nga "Handikos" në Istog, për përkrahje sipas mundësive me karburant dhe mirëmbajtjen e automjetit me targat 01-269-DH të Handikos-it dhe nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-7446 të datës 21.02.2019, e parashtruar nga "Handikos" për përkrahje sipas mundësive me karburant dhe mirëmbajtjen e automjetit me targat 01-269-DH i cili përdoret për nevoja të Handikos-it.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që "Handikosin" të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë Komunale.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria e Administratës Komunale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Lumdita Idrizaj- Drejtoreshë e " Handikos-it" ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-7446 të datës 21.02.2019, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet përkrahje me karburant dhe mirëmbajtjen e automjetit me targat 01-269-DH, i cili përdoret për transportin e fëmijëve të cilët vijnë në aktivitetet e rehabilitimit, bazuar në bashkësi, fizio-terapisë dhe psiko-socialit, të cilët transportohen çdo ditë nga shtëpitë e tyre për në qendër për aktivitetet e mësipërme dhe anasjelltas si dhe për nevoja tjera të kësaj qendre.

Kryetari shqyrtoi kërkesën dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Shefi autoparkut do të pajisë të përmendurën me vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë Komunale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare, Drejtoria e Administratës Komunale, kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Lumdita Idrizaj- Drejtoreshë e " Handikos-it" në Istog, Drejtoria e Administratës Komunale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-45/019	Data: Datum: 21.02.2019	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-6860 të datës 19.02.2019 të parashtruar nga Ismet Shoshi, nga Banja, Komuna e Istogut, për përkrahje furnizim me karburant dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MITATOHET: kërkesa Nr.06-553-6860 të datës 19.02.2019 e parashtruar nga Ismet Shoshi, për përkrahje me karburant për realizimin e vizitave mjekësore në spitalin e Pejës dhe i lejohet furnizimi i automjetit me 200 litra karburant për dy muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurin me Vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ismet Shoshi, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-6860, me 19.02.2019, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij për realizimin e vizitave mjekësore për shkak të sëmundjes nga e cila vuan.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Ismeti është i sëmurë, vuan nga sëmundja e kancerit dhe ka nevojë që të dërgohet për vizita mjekësore.

I lartpërmenduri është i sëmurë rënd dhe nuk ka mjete financiare të mjaftueshme që të sigurojë transportin e tij. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale, nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që t'i ndihmohet përmes furnizimit me karburant.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më Vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ismet Shoshi, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA**

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-46/019	Data: Datum: 25.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe nenin 7, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar sipas konkursit 02 Nr.32/19, të datës 13.02.2019 nxjerr:

V E N D I M

- Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.32/19, të datës 13.02.2019, për pozitën, **Zyrtar/e për aplikime në pagesa direkte - subvencione** (marrëveshje për shërbime të veçanta - në kohëzgjatja 2 muaj) 4 ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe në të caktohen:
 - Hasan Maxharraj, Zyrtar për Zhvillim të Bujqësisë, kryesues;
 - Kushtrim Zogaj, Zyrtar i Lartë për politika Bujqësore dhe Tregje , anëtar;
 - Fjollë Berisha, Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Medieve, anëtare;
 - Abedin Neziraj, Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm, anëtar dhe
 - Agim Ahmetaj, Zyrtar për Emergjencja, anëtar.
- Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën, Zyrtar/e për aplikime në pagesa direkte - subvencione (marrëveshje për shërbime të veçanta - në kohëzgjatja 2 muaj) 4 ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi në pajtim me procedurat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftojnë udhëheqësin e personelit për procedim të mëtejshëm.
- Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, zyra e personelit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen anëtarët e komisionit.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit, menaxheri i personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-47/019	Data: Datum: 25.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar sipas konkursit 02 Nr. 25/19 të datës 07.02.2019 nxjerr:

V E N D I M

- Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 02 Nr. 25/19 të datës 07.02.2019, për pozitën, **Përkthyes/e prej gjuhës shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas** (marrëveshje për shërbime të veçanta – kohëzgjatja 6 muaj) 1 ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale dhe në të caktohen:
 - Arlinda Kurtaj**, Udhëheqëse së Sektorit për punë administrative të Kuvendit Komunal, kryesuese;
 - Esat Smakic**, Zyrtar për Buxhet Financa 2, anëtar;
 - Emina Coković**, Zyrtare për Buxhet Financa 2, anëtare;
 - Faton Bujupi**, Zyrtar Ligjor 2, anëtar dhe
 - Kushtrim Gecaj**, Zyrtar për Shërbim me Qytetar, anëtar
- Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën, **Përkthyes/e prej gjuhës shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas** (marrëveshje për shërbime të veçanta – kohëzgjatja 6 muaj) 1 ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale në pajtim me procedurat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftojnë udhëheqësin e personelit për procedim të mëtejshëm.
- Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, zyra e personelit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen anëtarët e komisionit.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit, menaxheri i personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUCOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-48/019	Data: Datum: 25.02.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar sipas konkursit 02 Nr. 15/19 të datës 30.01.2019 nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.15/19 të datës 30.01.2019, për pozitën, **Inspektor/e Sanitar/e**, me numër të referencës RN00004300, 1 ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Inspektion dhe në të caktohen:

1. **Xhavit Blakaj**, Udhëheqës i Sektorit për Inspektion, kryesues;
2. **Arlinda Kurtaj**, Udhëheqëse e Sektorit për punë administrative të Kuvendit Komunal, anëtare;
3. **Hysen Mehmetaj**, Inspektor i Tregut , anëtar;
4. **Zekije Sutaj**, Udhëheqës i Sektorit Ligjor, anëtare dhe
5. **Fazli Stollaj**, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, anëtar;

2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën, **Inspektor/e Sanitar/e**, me numër të referencës RN00004300, 1 ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Inspektion në pajtim me procedurat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftojnë udhëheqësin e personelit për procedim të mëtejshëm.
3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, zyra e personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen anëtarët e komisionit.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit, menaxheri i personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-53/019	Data: Datum: 01.03.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimin në Komunitet në Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149, dhe Udhëzimin Administrativ Nr.8/2014 të MASHT-it, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar për Drejtor të SHFMU “ Bajram Curri “ nxjerr:

V E N D I M

- Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin e shpallur: 05Nr.48/019 të datës 14.02.2019, për pozitë Drejtor të SHFMU“ Bajram Curri “ dhe në komision caktohen:
 - Sami Ferati, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, Kryesues i Komisionit;
 - Bedri Hajzeraj, Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar;
 - Përfaqësuesi nga MASHT-i, anëtarë;
 - Përfaqësuesi i Këshillit të Shkollës, vëzhgues dhe
 - Përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve, vëzhgues.
- Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit të kandidatëve të cilët kanë konkurruar për pozitën Drejtor të SHFMU“ Bajram Curri” në kuadër të Drejtorisë për Arsim, në pajtim me procedurat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.3/L-149 dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe me listën e kandidatëve të përzgjedhur do të njoftojë Udhëheqësin e personelit për procedim të mëtejshëm.
- Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të Komisionit do ti kryej Drejtoria për Arsim.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen, anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Arsim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: të gjithë anëtarët e Komisionit, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


 Kryetari i Komunës
 Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-55/019	Data: Datum: 04.03.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-8385 të datës 01.03.2019 e parashtruar nga Faik Mavraj nga fsh. Staradran, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës Ila Mavraj për dializë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-8385 të datës 01.03.2019, e parashtruar nga Faik Mavraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës për dializë dhe i lejohet 57 litra karburant për muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që Faik Mavraj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Faik Mavraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-8385 të datës 01.03.2019, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i nënës për dializë. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Ila është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për dializë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për dializë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Faik Mavraj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

